

ÇFARË JANË PËRMBYTJET?

Përmbytjet janë fatkeqësi e shpeshtë që shkaktohen nga derdhja e ujit nga shtratet e lumenjve dhe liqeneve, duke shkakuar përmbytjen e vendeve përreth. Përmbytjet mund të ndodhin për shkak të reshjeve të mëdha, shkrirjes së shpejtë të borës dhe akullit, rrëzimeve të digave.

PASOJAT E PËRMBYTJEVE

Përmbytjet mund të shkaktojnë humbjen e jetëve ose lëndime të njërëzve, mbytjen e kafshëve, shkatërrimin e rezervave ushqimore dhe pronave, rrëzimin e shtëpive, dëmtimin e rrugëve dhe objekteve të tjera.

- **PËRMBYTJET MUND T'U NDODHIN TË GJITHËVE DHE MUND TË KENË PASOJA SERIOZE.**
- **DËGJONI ME KUJDES MË TË RRRITURIT DHE PËRPIQUNI TË JENI AFËR TYRE.**

MBANI MEND

112
THIRRJE
EMERGJENTE



PO CFARË MASASH MUND TË MARRIM NË SHKOLLË?

PARA PËRMBYTJES

1. HARTIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCEVE NË SHKOLLË



2. KRIJIMI I KOMISIONIT MENAXHUES TË EMERGJENCEVE



3. VEPRIMTARI PËRGATITORE PËR REDUKTIMIN E RREZIKUT


- Kontroll i përgjithshëm i objektit të shkollës cdo fillim viti shkollor.
- Leximi i rregulloreve në shkollë
- Prezantimi i hartave të evakuimit në klasa për të dalë nga shkolla
- Përcaktimi i sistemit të alarmit të veçantë për evakuim
- Përgatitja/trainimi i mësuesve për emergjencat shëndetësore/ ndihmën e shpejtë
- Informim/trajnime për komunitetin e shkollës për të menaxhuar fatkeqësitë
- Kryerja e simulimeve për rastet e emergjencave në shkolla




GJATË PËRMBYTJES




Evakuimi nga klasat e katit përdhës në katin e mësipërm të shkollës



1. Marrja e kutive të ndihmes se pare gjate levizjes
2. Levizja e sendeve me vlerë/ mobiljeve që të mos preken nga uji



Mbyllja e saracineskave të ujit dhe ulja e automatëve



1. Stafi pedagogjik njofton prindërit për femijët
2. Drejtuesi i shkollës komunikon me autoritetet përkatëse lokale dhe arsimore

PAS PËRMBYTJES



Dezinfektimi shkollës pas përmbytjes



Kryerja e analizave të ujit të pijshëm



Mos përdorimi i ujit të tualeteve deri në njoftimin nga Drejtoria e Shëndetit Publik



Mbështetja psikologjike e nxënësve mbas situatës së emergjencës